

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.2021

**PËR
MARRJEN E MASAVE PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË
RASTET E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE KONFLIKTEVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 3131, datë 18.7.1969 “Mbi aderimin e Republikës Popullore të Shqipërisë në Konventën “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur”, si dhe në protokollin dhe rregulloren mbi zbatimin e Konventës”, adoptuar nga konferenca e UNESCO-s në Hagë, më 14 maj 1954”; ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, pika 3 e nenit 11 të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit përgjegjës për kulturën, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, dhe ministrit përgjegjës për mbrojtjen, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e:

- a) fatkeqësive natyrore
- b) konflikteve të armatosura.

2. Autoritetet shtetërore qendrore dhe vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe pronarët ose poseduesit e pasurive kulturore kanë detyrimin dhe përgjegjësinë nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit, për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore gjatë fatkeqësive natyrore, dhe konflikteve të armatosura.

**II. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË
KULTURORE DHE BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL NË RASTET E
FATKEQËSIVE NATYRORE**

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike kanë përgjegjësinë për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut, si dhe

organizimin e angazhimin në përballimin e emergjencave civile në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktesh të armatosura.

2. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgiminë kulturore janë:

- a) Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;
- b) Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- c) Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë;
- d) Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë;
- e) Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat;
- dh) Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë;
- f) Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë;
- ë) Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër;
- g) Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike;
- h) muzetë, sipas parashikimeve të nenit 193, të ligjit 27/2018“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- gj) institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar;
- i) Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
- j) Instituti i Arkeologjisë, në varësi të Akademisë së Studimeve Albanologjike
- k) Instituti i Antropologjisë dhe Studimit të Artit, në varësi të ASA
- l) Pushteti Vendor, që administron muze vendorë dhe fondet e pasurive kulturore në administrim të institucioneve kulturore.
- m) Institucionet publike qendrore që administrojnë pasuri kulturore
- n) Inspektorati Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore, në momentin e krijimit sipas ligjit ligjit 27/2018“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

3. Në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, krijohet dhe funksionon njësi përgjegjëse e **Emergjencave Civile për pasuritë kulturore**. Kjo njësi këshillon për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive natyrore ne objektet e trashëgimisë kulturore.

4. Njësia e Emergjencave Civile për pasuritë kulturore bashkërendon punën me Agjencinë Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore të përcaktuara në pikën 2 të Kapitullit II, për:

- a) parandalimin, menaxhimin e riskut te fatkeqësive natyrore ne pasuritë kulturore,
- b) menaxhimin e fatkeqësive dhe te emergjencave civile në pasuritë kulturore,
- c) zvogëlimin e riskut dhe marrjen e masave në funksion të ofrimit të shërbimeve të emergjencës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

5. Bashkëpunimi ndërinstitucional në rastet e fatkeqësive natyrore komunikimi i institucioneve bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar. Në rastet e komunikimit verbal, njësi për Emergjencat Civile në pasuritë kulturore pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ruan përmbytjen e bisedave, të njoftimeve apo të kërkesave të marra e të dhëna përmes përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit.

III. MASAT PËR RUAJTJEN E PASURIVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË RAST TË FATKEQËSIVE NATYRORE.

1. Masat paraprake për ruajtjen e pasurive kulturore në rastin e fatkeqësive natyrore janë:

- a) Masat paraprake
- b) Masat për përbalimin dhe rehabilitimin

2. Masa paraprake për ruajtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore në rastin e fatkeqësive natyrore janë:

- a) Hartimi i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Ministria përgjegjëse për mbrojtjen.
- b) Hartimin e Planeve të emergjencave civile në nivel qarku dhe në nivel vendor nga institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në bashkëpunimin me institucionet e qarkut dhe ato vendore.
- c) Ndërtimi i strukturave për mbrojtjen fizike parandaluese të pasurive kulturore për minimizimin e efekteve negative të fatkeqësive natyrore në pasuritë kulturore nga institucionet përgjegjëse për administrimin e trashëgimisë kulturore.
- d) Inspektimi dhe monitorimi periodik i gjendjes së pasurive kulturore nga institucionet e specializuara për trashëgiminë kulturore, në kuadër të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore sipas zonave të administrimit.
- e) Hartimi i një databaze të integruar të riskut, sipas një formati të unifikuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike, muzeve ku përcaktohet:
 - i. lista e riskut ku identifikohen pasuritë kulturore të dëmtuara paraprakisht, ato të rrezikuara apo me potencial rreziku në të ardhmen në bazë të tipologjisë së riskut nga fatkeqësitë natyrore, të ndara sipas karakteristikave të pasurisë kulturore apo sipas zonave.;
 - ii. rreziqet që kërcënojnë trashëgiminë kulturore të ndara sipas karakteristikave të pasurive kulturore apo sipas zonave
 - iii. kontaktet e poseduesve të pasurive kulturore;
- f) Rishikim i databazës në mënyrë periodike çdo dy vjet me përjashtim të rasteve të veçanta kur miratohet nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) e cila i komunikohet dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
- g) Hartimi i dokumentit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë të bashkive në territorin e së cilës ndodhen pasuritë kulturore.
- h) Organizimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe sistemit të alarmit në rast fatkeqësie natyrore nga institucionet e specializuara për trashëgiminë kulturore
- i) Vendosja e sinjalistikës në pasuritë kulturore dhe institucionet e trashëgimisë kulturore të aksesueshme për publikun.
- j) Regjistrimi dhe inventarizimi pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) dhe digjitalizimi i pasurive kulturore dhe materialeve arkeologjike, të

cilat qëndrojnë *in situ* të ekspozuara në zona arkeologjike/parqe arkeologjike nga autoritetet që i kanë në administrim/posedim ato.

- k) Hartimi i planeve të menaxhimit të riskut dhe sigurimit të masave të shpëtimit në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera të cilat mund të janë pjesë përbërëse të planeve të menaxhimit të integruar të pasurive kulturore, në zbatim të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Në rastin e pasurive kulturore me rëndësi të veçantë apo në rastet kur risku është më i lartë, plani i riskut është dokument më vete.
- l) Hartimi i planeve të veprimit sipas llojit të fatkeqësisë natyrore.
- m) Hartimi i planeve të emergjencës për zhvendosjen dhe grumbullimin e pasurive kulturore të luajtshme. Lista e pasurive miratohet nga KKTKM sipas propozimit të argumentuar të institucioneve që kanë në administrim këto pasuri. Zhvendosja bëhet sipas parashikimeve të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.
- n) Trajnimi i strukturave të përgjegjëse me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- o) Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i opinionit publik, pronarëve dhe/ose administratorëve të pasurive kulturore për parandalimin e risqeve të fatkeqësive natyrore dhe ruajtjen e pasurive kulturore.
- p) Nxitja e pronarëve dhe/ose administratorëve të pasurive kulturore për kompletimin, me pajisje paralajmëruese, me masa parandaluese dhe mjete portative automatike për mbrojtjen nga zjarri të objektit.

2. Masat për përballimin dhe rehabilitimin e pasurive të trashëgimisë kulturore si pasojë e fatkeqësive natyrore:

- a) Angazhimi i strukturave përkatëse në ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve të varësisë, për realizimin e planeve apo rregulloreve përkatëse me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mjedisit dhe të qenies njerëzore.
- b) Nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional, për angazhimin e Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera operationale të sistemit të mbrojtjes civile në varësi të llojit të fatkeqësive natyrore
- c) Vlerësimi i menjëhershëm i dëmit për të përcaktuar humbjet, shkallën e dëmtimit të pasurive kulturore sipas formularëve të vlerësimit për pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme, pjesë përbërëse të procedurave të emergjencës civile.
- d) Planifikimi i masave dhe hartimi i ndërhyrjeve emergjente në pasuritë kulturore brenda zonave të riskut nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.
- e) Hartimi i projekteve të restaurimit, rikonstruksionit, rindërtimit nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit.
- f) Stimulimi i vullnetarizimit në procesin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, e cila realizohet nën mbikëqyrjen e ekspertëve të trashëgimisë kulturore

IV.MASAT PËR RUAJTJEN E PASURIVE KULTURORE NË RAST TË KONFLIKTEVE TË ARMATOSURA

- 1. Masat për ruajtjen e pasurive kulturore në rastet e konflikteve të armatosura ndahen në:
 - c) masa paraprake në kohë paqeje;

- d) masa gjatë konfliktit të armatosur.
2. Masat paraprake në kohë paqeje synojnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore, bazuar në pasojat e parashikuara gjatë një konflikti të armatosur. Në këto masa përfshihen:
- a) inventarizimi i pasurive kulturore;
 - b) plani i masave emergjente kundër zjarrit ose qëndrueshmërisë statike të pasurive kulturore, i miratuar nga ministri përgjegjës për mbrojtjen dhe ministri përgjegjës për kulturën;
 - c) plani i zhvendosjes së pasurive kulturore të luajtshme dhe plani i mbrojtjes *in situ* të trashëgimisë të paluajtshme, i miratuar nga ministri përgjegjës për mbrojtjen dhe ministri përgjegjës për kulturën.
 - ç) integrimi në rregulloret aktuale ushtarake të dispozitave për mbrojtjen e pasurive kulturore dhe përcaktimi i bashkëpunimit të forcave të armatosura me autoritete e tjera për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
 - d) sigurimin e trajnimit të strukturave të përgjegjëse me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

A. VENDOSJA NË MBROJTJE TË VEÇANTË

1. Mbrojtja e veçantë nënkupton përjashtimin e pasurive kulturore të caktuara nga subjektet e sulmeve ushtarake ose përdorimit të tyre për qëllime ushtarake, duke përfshirë dhe territorin përreth tyre.
2. Të gjitha pasuritë kulturore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të cilat vendosen në mbrojtje të veçantë në raste të konfliktit të armatosur regjistrohen në *“Regjistrin ndërkombëtar të vlerave kulturore të vëna në mbrojtje të veçantë”*, pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsimin, shkencën dhe kulturën.
3. Në mbrojtje të veçantë vendosen:
 - a) pasuritë kulturore të paluajtshme të grupuara, sipas përcaktimeve të neneve 50-51, të ligjit 27/2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”*;
 - b) pasuritë kulturore të paluajtshme me interes të veçantë;
 - c) Vend-depozitimet për ruajtjen e pasurive kulturore të luajtshme.
 - d) pasuri kulturore *“me rëndësi universale”*, *“me rëndësi kombëtare”* në kuptim të legjislacionit për trashëgiminë kulturore
4. Kriteret për vendosjen në mbrojtje të veçantë për pasuritë kulturore janë:
 - a) objekti të jetë vënë në mbrojtje në kuptim të legjislacionit shqiptar për trashëgiminë kulturore
 - b) objekti të jete deklaruar pasuri kulturore *“me rëndësi universale”*, *“me rëndësi kombëtare”* në kuptim të legjislacionit ne fuqi për trashëgiminë kulturore.
 - c) objekti nuk përdoret për qëllime ushtarake, duke përfshirë venddepozitimet dhe territorin përreth tyre.

5. Kriteret për vendosjen në mbrojtje të veçantë për venddepozitimet për ruajtjen e pasurive kulturore të luajtshme:
 - a) ndodhen në largësi nga qendrat e mëdha industriale ose në largësi nga çdo objektiv ushtarak që përbën një pikë të ndjeshme, p.sh.: aeroportet, stacionet e transmetimit, stabilimentet e ngritura në funksion të mbrojtjes kombëtare, portet ose stacionet hekurudhore me rëndësi ose rrugët e rëndësishme e komunikacionit;
 - b) nuk përdoren për qëllime ushtarake;
 - c) strehime për pasuri kulturore të luajtshme pavarësisht nga vendndodhja, nëse vlerësohet se ndërtimi nuk dëmtohet nga bombardimet.
6. Institucionet e specializuara për trashëgiminë kulturore dhe muzetë paraqesin pranë Sekretarisë Teknike së Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale kërkesën për vënien në mbrojtje të veçantë pasuritë kulturore, në varësi të pasurive kulturore që administrojnë apo posedojnë gjatë konfliktit të armatosur.
7. Kërkesa shoqërohet me relacion shpjegues sipas kategorizimeve dhe kritereve të përmendura në këtë vendim dhe udhëzimeve të Konventës “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur”.
8. Ministri përgjegjës për kulturën në konsultim paraprak me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë juridike miraton listën përfaqësuese për regjistrim në “Regjistrin ndërkombëtar të vlerave kulturore të vëna nën mbrojtje të veçantë”.
9. Lista i propozohet drejtorit të përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsimin, shkencën dhe kulturën për regjistrimin në “Regjistrin ndërkombëtar të vlerave kulturore të vëna nën mbrojtje të veçantë”, për pasuritë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.
10. Nëse-gjatë një konflikti të armatosur nga rrethanat e paparashikuara vlerësohet e nevojshme ngritja e një venddepozitimi të improvizuar dhe kërkohet vendosja në mbrojtje të veçantë, njoftohet menjëherë komisar i përgjithshëm që ushtron misionin pranë Shqipërisë.

B.SHENJA DALLUESE

1. Shenja dalluese përbëhet nga një prizëm me majën të drejtuar poshtë, e ndarë në katër pjesë në formë Xe—je (X), me ngjyrë të kaltër dhe të bardhë (*stema përbëhet nga një katrorë me ngjyrë të kaltër një nga këndet e së cilës i drejtohet majës së stemës dhe një trekëndësh me ngjyrë të kaltër mbi katroren, të dyja duke u kufizuar me një trekëndësh të bardhë nga çdo anë*).
2. Shenja dalluese e përsëritur tri herë përdoret vetëm për:
 - a) vlerat e trashëgimisë kulturore të paluajtshme në mbrojtje të veçantë
 - b) zhvendosjen e vlerave të trashëgimisë kulturore;
 - c) venddepozitimet e improvizuara.
3. Vendi ku vendoset shenja dalluese dhe shkalla e vizibilitetit të saj përcaktohet nga vlerësimi i përbashkët i ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen dhe ministrisë përgjegjëse për kulturën.
4. Shenja dalluese paraqitet në formën e një flamuri, vizatohet mbi një objekt ose paraqitet në çdo formë tjetër të vlefshme.
5. Në rastin e pasurive kulturore të paluajtshme nën mbrojtje të veçantë shenja dalluese vendoset:

- a) në distancat e rregullta të mjaftueshme për të shënuar dhe treguar qartë perimetrin e një qendre historike, parqeve me interes artistik dhe kulturor
 - b) në hyrje të pasurive kulturore të paluajtshme.
6. Në rastet e zhvendosjes të pasurive kulturore të luajtshme, me qëllim ruajtjen nga konflikti i armatosur, shenja vendoset në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht e dukshme ditën, nga ajri, si edhe nga toka.

7. Shenja dalluese përdoret e veçuar për:

- a) vlerat të trashëgimisë kulturore të cilat nuk janë vënë nën mbrojtje të veçantë;
- b) personat e ngarkuar me funksionet e kontrollit;
- c) personelin e caktuar për mbrojtjen e vlerave kulturore;
- ç) letërnjoftimet përkatëse.

8. Personat e parashikuar në gërmat "b" dhe "c" të pikës 7 të ndarjes B të kreut IV, kanë të drejtë të mbajnë flamuj rreth krahut me shenjën dalluese, të lëshuar dhe të vulosur nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen.

9. Personat e përcaktuar në gërmat "b" dhe "c" të pikës 7 të ndarjes B të kreut IV mbajnë letërnjoftim të posaçëm të pajisur me shenjën dalluese. Ky letërnjoftim përmban:

- a) emrin e mbiemrin,
- b) datën e lindjes, titullin ose gradën, ose cilësinë e të interesuarit.
- c) fotografinë e titullarit
- d) firmën ose shenjat e gishtave të tij ose të dyja së bashku.
- e) vulën e thatë të Ministrisë së Mbrojtjes

10. Ministria përgjegjëse për mbrojtjen cakton dhe miraton modelin të letërnjoftimit dhe ia komunikon palës kundërshtare.

11. Çdo letërnjoftim lëshohet të paktën në dy kopje nga të cilat një ruhet nga autoriteti që e ka lëshuar.

12. Personat e ngarkuar për kontrollin dhe mbrojtjen e vlerave kulturore mbajnë shenjat dalluese dhe letërnjoftimet në baze të kritereve të Konventës të miratuar nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen.

13. Pas miratimit nga Komisarit të Përgjithshëm, ministria përgjegjëse për mbrojtjen vijon me vendosjen e shenjës dalluese.

C. ZHVENDOSJA DHE QARKULLIMI I PASURIVE KULTURORE

1. Zhvendosja e pasurive kulturore të luajtshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj në situatë të konfliktit të armatosur realizohet vetëm nën mbrojtje të veçantë.
2. Zhvendosja nën mbrojtje të veçantë jashtë territorit bëhet nën mbikëqyrjen me karakter ndërkombëtar dhe e pajisur me shenjën dalluese të përcaktuar në këtë vendim.
3. Për zhvendosjen nën mbrojtje të veçantë të pasurive kulturore kërkesa i drejtohet komisarit të përgjithshëm për vlerat kulturore
4. Kërkesa përmban:
 - a) arsyet për të cilat do të realizohet zhvendosja;

- b) inventarin e pasurive kulturore;
 - c) rëndësia e vlerave të trashëgimisë kulturore;
 - ç) vendin aktual të këtyre pasurive kulturore;
 - d) venddepozitimi i ri;
 - dh) mjetet e transportit;
 - e) itinerarin që do të ndiqet;
 - ë) datën e parashikuar për transportimin;
 - f) çdo njoftim tjetër të nevojshëm.
5. Gjatë konfliktit të armatosur duhet të bëhet zhvendosja e pasurive kulturore, nëse ndodhen pranë një objekti ushtarak ose të mundësohet mbrojtja e përshtatshme *in situ* e pasurisë.
 6. Ndalohet eksportimi i pasurive kulturore të një territori të pushtuar, gjatë një konflikti të armatosur.
 7. Çdo pasuri kulturore e importuar brenda territorit shqiptar që ka ardhur direkt ose tërthorazi nga një territor i pushtuar, vihet në mbrojtje. Kjo bëhet menjëherë pas importimit ose me kërkesën të autoriteteve të territorit të pushtuar.

Ç. VEPRIMTARITË ARKEOLOGJIKE NË RAST TË KONFLIKTEVE TË ARMATOSURA

1. Gjatë konflikteve të armatosura si rregull ndalohet çdo veprimtari arkeologjike. Veprimtaria arkeologjike lejohet vetëm në rastet përjashtimore, me qëllim shpëtimin, inventarizimin dhe ruajtjen e gjetjeve arkeologjike.
2. Për rastet përjashtimore veprimtaritë arkeologjike kryhen nën monitorimin dhe të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen.

D.MASA USHTARAKE

1. Në përbërje të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë parashikohen trupa/personel të dedikuar për mbrojtjen e pasurive kulturore.
2. Në rregulloret ose udhëzimet aktuale ushtarake integrohen dispozita të tilla që sigurojnë respektimin e Konventës “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur”.
3. Gjatë operacioneve ushtarake secila palë në konflikt:
 - a) verifikon që objektivi i sulmit nuk është pasuri kulturore pjesë e “Regjistrit ndërkombëtar të vlerave kulturore të vëna në mbrojtje të veçantë”;
 - b) ndërmerr të gjitha masat paraprake të mundshme në zgjedhjen e mjeteve dhe metodave të sulmit, me qëllim shmangien dhe në çdo rast minimizimin e dëmtimit të pasurisë kulturore të vënë në mbrojtje të veçantë;
 - c) evitojnë sulme që shkaktojnë dëmtime të tërthorta të pasurisë kulturore të vënë në mbrojtje të veçantë;
 - ç) ndalon ose pezullon çdo sulm të inicuar pranë pasurisë kulturore të vënë në mbrojtje të veçantë;

- d) zbaton udhëzime të tjera për zbatimin e Konventës “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur”, për mbrojtjen e pasurisë kulturore në rregulloret ushtarake.

V. EDUKIMI DHE TRAJNIMI

1. Ministria përgjegjëse për kulturën, nëpërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, bashkëpunon me institucionet e specializuara me anë të programeve të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të tjera ose konflikteve të armatosura, si dhe parandalimin e rrezikut të tyre.

2. Ministria përgjegjëse për kulturën bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen dhe ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen për trajnimin e strukturave të mbrojtjes civile, me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

3. Trajnimet e specializuara në nivel profesional dhe teknik janë ndërdisiplinore dhe realizohen duke marrë parasysh pikat e mëposhtme:

- a) realizimin nëpërmjet ekspertizës së kualifikuar që të mundësojë njohuritë specifike mbi parandalimin, përbalimin e fatkeqësive natyrore dhe të tjera dhe ndërhyrje emergjente në objekte dhe site të trashëgimisë kulturore të rrezikuara;
- b) vlerësimin dhe përcaktimin e vulnerabilitetit dhe të riskut potencial, veprimet parandaluese dhe mbrojtëse për të minimizuar apo eliminuar riskun, metodat dhe teknikat e ndërhyrjeve konservuese dhe mirëmbajtëse etj.;
- c) njohjen e teknikave tradicionale dhe përditësimin me teknikat dhe metodat më bashkëkohore;

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministria përgjegjëse për kulturën, ministria përgjegjëse për mbrojtjen, institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e specializuara përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama